



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1241/4 Prot.

Tiranë, më 22.09.2025

V E N D I M

Nr. 220, Datë 22. 09. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.187, datë 01.09.2025, e z. A.M., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se:

Unë, A. M., dëshiroj të parashtoj rastin e mëposhtëm lidhur me trajtimin që kam marrë nga institucionet e sigurimeve shoqërore, i cili më ka vendosur në një situatë të paqartë dhe diskriminuese në krahasim me pensionistë të tjerë që kanë përfituar pension suplementar. Më 24 korrik 2025, në sistemin e e-Albania pamë përgjigjen për pensionin e pleqërisë dhe atë suplementar; të dyja ishin refuzuar. Arsyeja për pensionin e pleqërisë ishte se librezja e punës nuk ishte vulosur. Arsyeja për suplementarin ishte se nuk njihen të gjitha vitet e punës në uzinë, megjithëse ekziston dokumentacion i plotë. Më 25 korrik 2025, librezja e punës u mbyll në vendin e fundit të punës. Po atë ditë kontaktova numrin 0698000063. Operatorët dhanë versione të ndryshme: herë thoshin “nuk ju takon”, herë “bëni ankim në rajonal”, herë “në qendror”. Po atë

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo karakteristikë personale.

ditë dërguam edhe email dhe përgjigja ishte që të bënim “Kërkesë për rishqyrtim pensioni”, ndërkohë që pensioni i pleqërisë s’kishte dalë ende.

Më 31 korrik 2025 u bë ribërja e aplikimit për pension, pas mbylljes së librezës. Nga 26 korrik deri më 1 gusht 2025, pas instruksioneve kontradiktore, u bë edhe kërkesë për rishqyrtim pensioni, ndonëse pensioni i pleqërisë ende nuk kishte dalë. Ditën tjetër operatorët pohuan se ishte veprim i gabuar, pasi kërkesa duhej bërë “në rajonal” dhe jo “në qendror”, dhe se “rishqyrtimi” nuk bëhej pa dalë më parë pensioni i pleqërisë. Më 30 korrik 2025, komisioni rajonal ktheu përgjigje se nuk është kompetent për këtë çështje dhe të ndiqet rruga ligjore, pra një sorollatje sa andej këtej, kur informacionin për të bërë ankesën te rajonali e qendrori na i dhanë po vetë punonjësit e sigurimeve, ndërkohë që këto institucione pretendojnë se s’janë kompetente për këtë shërbim. Më 18 gusht 2025 u caktua pensioni i pleqërisë në shumën 15.498 lekë.

Pasi riteletonuam, ata e rishqyrtuan dhe e korrigjuan në 16.260 lekë, duke pranuar se ishte bërë gabim në llogaritje. Për suplementarin, përsëri u tha se nuk është kompetencë e rajonalit dhe se duhet të prisnim përgjigje nga qendrori. Më 19 gusht 2025, në ISSH na thanë se “nuk merren ata”, ndërsa rajonali përsëri tha se “nuk janë kompetentë”, dhe nuk më lejuan të takoja një person kompetent, por zoteria, me një arrogancë, më kërkonte të mos insistoja e të shkoja te DRSSH, ndërkohë që DRSSH ishte ajo që më dërgoi te ISSH.

Theksojmë se vitet e punës që nuk janë njohur për efekt të pensionit suplementar janë vitet 1979–1985. Pikërisht gjatë kësaj periudhe, në vitin 1984, unë kam marrë një certifikatë mirënjohjeje për kontributin dhe vlerësimin në punë. Megjithatë, këto vite janë njohur për caktimin e pensionit të pleqërisë, por jo për suplementarin, çka përbën një trajtim kontradiktor dhe diskriminues.

Dua të theksoj se edhe dy vitet e ushtrisë nuk më janë njohur në përlllogaritje. Gjithashtu, jam ndjerë gjatë gjithë kësaj periudhe i tensionuar dhe i rënduar nga ana shëndetësore, për shkak të shqetësimit të vazhdueshëm që më ka shkaktuar kjo situatë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rregullimin e viteve që nuk i njihen për pëfitimin e pensionit suplementar.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me shkresën nr.1241/1 prot., datë 08.09.2025 të Komisionerit, është kërkuar nga subjekti ankues që të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin si më poshtë:

- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkakun e pretenduar për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju e mbartni këtë shkak të pretenduar.
- Përveç përshkrimit të shkakut, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si ky shkak ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tij.
- Informacion nëse këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht; nëse po, na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë së depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Subjekti ankues, sipas Fletës së Lajmërim-Marrjes së Zyrës Postare nr. RR 790844395 AA, datë 08.09.2025, rezulton se ka marrë në dorëzim shkresën nr.1241/1 prot., datë 08.09.2025 të Komisionerit, por nuk dërgoi asnjë informacion apo dokumentacion lidhur me shkakun e pretenduar.

Në po të njëjtën ditë, më datë 08.09.2025, nga ankuesi është dërguar një email me përmbajtje: *Përshëndetje; Jam A. M., dhe kam bërë një ankesë të regjistruar me numrin 187, dua t'ju njoftoj që deri tani akoma nuk e kam marrë një përgjigje nga ISSH për situatën time (janë akoma brenda afatit kohor ligjor nga momenti që është bërë ankesa me shkrim, ndërsa ankesa nëpërmjet kontakteve telefonike dhe në e-Albania ka nisur që në korrik, siç ua kam komunikuar në ankesë). Mbetem në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj!*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore*

të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

Përsa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë shkaqesh². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh³.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e

² Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

³ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferenat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Referuar kërkesës dhe shqetësimeve të paraqitura nga z. A. M., sqarojmë se trajtimi i kërkesave për pension suplementar në bazë të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në industrinë e naftës dhe të gazit, dhe në metalurgji”, i ndryshuar, është në kompetencën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), në bashkëpunim me Degët Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH). Vlerësimi i kushteve të përfitimit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të punës bëhet nga komisionet teknike dhe juridike brenda këtyre institucioneve, në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, konkretisht VKM nr. 526/2019, VKM nr. 447/2020 dhe VKM nr. 448/2020.

Ankuesi ka të drejtë drejtohet Komisionit Rajonal të Ankimimit dhe pastaj, nëse duhet, Komisionit Qendror të Ankimimit brenda procedurave administrative që rregullohen me ligjin për sigurimet shoqërore. Nëse, pas përfundimit të së gjitha këtyre fazave administrative, ankuesi konsideron se vendimi nuk është i drejtë ose ligjor, ai ka të drejtë të kërkojë mbrojtje në Gjykatën Administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të

pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr.187, datë 01.09.2025 të subjektit ankues z. A. M., pasi bazuar në ligjin nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* të ndryshuar, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA